



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Faqe | 1

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, më __.__.2026

PËR

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E DHËNIES SË AUTORIZIMEVE”, MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 99, DATË 07.06.2017 TË AMA-s të ndryshuar

Në mbështetje të nenit 19, pika 1, gërma “ë”, nenit 54, pika 5 dhe nenit 64 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në vendimin nr. 99, datë 07.06.2017 të AMA-s “Për miratimin e rregullores “Për procedurat dhe kriteret e dhënies së autorizimeve”, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 10 të rregullores pas pikës 2.5 a) shtohet pika b) me këtë përmbajtje:

b) Përfundimisht, OSHMA-të që operojnë në bashki ku numri i banorëve është më i vogël se 30.000, nuk i nënshtrohen kufizimit për numrin minimal të punonjësve të siguruar, për sa kohë ushtrimi i veprimtarisë realizohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 2

Në nenin 10 të rregullores pas pikës 3.4 a) shtohet pika b) me këtë përmbajtje:

b) Përfundimisht, OSHMA-të që operojnë në bashki ku numri i banorëve është më i vogël se 30.000, nuk i nënshtrohen kufizimit për numrin minimal të punonjësve të siguruar, për sa kohë ushtrimi i veprimtarisë realizohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 3

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen e internetit të AMA-s.